FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 201

Tiranë – E premte, 24 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13394, datë 20.12.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	20473
Dekret i Presidentit nr. 13395, datë 20.12.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	20473
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 373/4, datë 21.12.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar.....	20473
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 373/5, datë 23.12.2021	Për një shtesë në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar.....	20474
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 561, datë 23.12.2021	Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit COVID-19, për punonjësit e administratës publike, punonjësit e supermarketeve dhe qendrave tregtare.....	20474
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 564, datë 23.12.2021	Për një shtesë në urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve", të ndryshuar.....	27475
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 565, datë 23.12.2021	Për një shtesë dhe disa ndryshime në urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020, "Për ngritjen e Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri", të ndryshuar.....	27475
Urdhër i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural nr. 380, datë 22.12.2021	Për hapjen e thirrjes së katërt për aplikime për programin IPARD II.....	27476
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 639, datë 22.12.2021	Për vendosjen e një regjimi sforco të peshkimit për speciet kryesore fundore në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [rekomandimi GFCM/44/2021/1].....	27476

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimet nr. 614/10, datë 21.12.2021 | Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti "Zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë, faza 2", Bashkia Tiranë..... 20479

DEKRET
Nr. 13394, datë 20.12.2021

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 16, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fatime Asim (Hasim) Demiri (Qato)
2. Suzana Rakip Sarkaro (Mezini)
3. Fatbardha Rexho Selmani
4. Stavro Lefter Kapurani
3. Ines Besnik Hasanaj
4. Eduart Spiro Toni
5. Vesna (Dritë) Velo Kontiq
6. Arber Engjellush Llenga
7. Qemal Kamber Haxhihyseni
8. Liza Preng Brunga
9. Raphaela-Pia Luan Brunga
10. Adisa Sinan Sadedinaj
11. Leonora Elmaz Kusaku
12. Lamberto Harilla Hanxhari
13. Aida Hasan Koçi (Koci)
14. Lukas Nasim Koçi (Koci)
15. Ervin Bujar Luzi
16. Sunila Faik Margjini
17. Sokol Din Daci
18. Michelle Sokol Daci
19. Everist Niazi Limaj
20. Migena Hasan Senko (Muça)
21. Ersan Flodian Senko
22. Besian Ivan Kërmezo
23. Bujar Bajram Hartig (Doksani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 13395, datë 20.12.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lida Rexhep Alibesi
2. Entela Hasan Gadime

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR
Nr. 373/4, datë 21.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, germa "d", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 4881, datë 2.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri në datën 21.12.2021" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në datën 4.1.2022".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 373/5, datë 23.12.2021

PËR NJË SHTESË NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, germa "d", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5180, datë 23.12.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar, bëhet shtesa si vijon:

1. Pas pikës 1 të urdhrit, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Përjashtim, nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të urdhrit, bëhet vetëm për natën e ndërrimit të viteve, datë 31.12.2021–1.1.2022.".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 561, datë 23.12.2021

PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19, PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS PUBLIKE, PUNONJËSIT E SUPERMARKETEVE DHE QENDRAVE TREGTARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 18, pika 7, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimeve të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 4881, datë 2.12.2021 dhe nr. 5180, datë 23.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Punonjësit e administratës publike, punonjësit e supermarketeve dhe të qendrave tregtare, si një ndër kategoritë që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, me qëllim për të penguar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga Sars-Cov-2 (COVID-19), duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës, duke filluar nga data 4.1.2022, një nga dokumentet e mëposhtme:

a) certifikatë vaksinimi COVID-19, të lëshuar nga *e-Albania,* që vërteton vaksinimin e plotë, në formë digjitale apo të printuar;

b) test PCR-je, çdo 5 ditë, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2;

c) certifikatë shërimi COVID-19 të lëshuar nga *e-Albania* ose dokument të lëshuar nga autoritetet shëndetësore të vendit, që provon shërimin nga infeksioni Sars-Cov-2, me vlefshmëri deri në 6 muaj pas shërimit.

2. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

3. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e administratës

publike dhe subjektet private që ushtrojnë aktivitet tregtar në supermarkete apo qendra tregtare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 564, datë 23.12.2021

PËR NJË SHTESË NË URDHRIN NR. 100, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, FAST FOOD DHE LOKALEVE", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 7, pika 4, germa b, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5180, datë 23.12.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve", të ndryshuar, bëhet shtesa si vijon:

1. Pas pikës 1 të urdhrit, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Përjashtim, nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të urdhrit, bëhet vetëm për natën e ndërrimit të viteve, datë 31.12.2021–1.1.2022.".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 565, datë 23.12.2021

PËR NJË SHTESË DHE DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 53, DATË 31.1.2020, "PËR NGRITJEN E KOMITETIT TË PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN E PËRHAPUR NGA CORONAVIRUS I RI", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 33, germa "ë", të ligjit nr. 15, datë 10.3.2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020, "Për ngritjen e Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri", të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 të urdhrit:

a) Germa "c" riformulohet si vijon:

"c) znj. Albana Fico, drejtor, QSUT, anëtar".

b) Pas germës "m" shtohet germa "n" me këtë përmbajtje:

"n) znj. Eugena Tomini, drejtor, ISHP, anëtar".

2. Pika 3 ndryshon si vijon :

"3. Sekretar i Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri është znj. Elona Kureta, nga Instituti i Shëndetit Publik".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 380, datë 22.12.2021

PËR HAPJEN E THIRRJES SË KATËRT PËR APLIKIME PËR PROGRAMIN IPARD II

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural"; në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural", të ndryshuar; në marrëveshjen kuadër, marrëveshjen sektoriale për IPARD II dhe Marrëveshjen e financimit,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes së katërt për aplikime nga Programi IPARD II, për aplikimet, respektimin e kërkesave për informimin, publicitetin dhe transparencën, me qëllim garantimin e vizibilitetit dhe llogaridhënien e fondeve të BE-së.

2. Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur në udhëzuesin për aplikantët, lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve, i cili mund të kërkohet si një kopje e printuar (falas) në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR), gjatë orëve të punës 08:00–16:30, çdo ditë të hënë deri të enjte, dhe 08:00–14:00, çdo të premte.

3. Gjithashtu, udhëzuesi për aplikantët dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të shkarkohen në versionin zyrtar nga data 10 dhjetor 2021, nga faqja e internetit: www.azhbr.gov.al, www.ipard.gov.al dhe www.bujqësia.gov.al.

4. Dorëzimi i aplikimeve fillon nga data 10 janar 2022 deri në datën 25 shkurt 2022, sipas orarit zyrtar 08:00–16:30, çdo ditë të hënë deri të enjte, dhe 08:00–14:00 çdo të premte. Çdo aplikim i mbërritur në AZHBR pas datës 25 shkurt 2022 do të refuzohet. Të gjitha afatet e mësipërme do të përllogariten, duke u bazuar në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

5. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së, në zarfe të mbyllura, me titullin "Thirrje për dorëzimin e aplikimeve", së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin "Të mos hapet përpara dorëzimit".

Aplikimet duhet të dorëzohen ose:

- nëpërmjet dërgesës postare rekomande; ose
- dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural Rruga "Muhamet Gjollesha", nr. 56, Tiranë, Shqipëri. Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo *e-mail)* apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Eranda Selmanaj

URDHËR
Nr. 639, datë 22.12.2021

PËR VENDOSJEN E NJË REGJIMI SFORCO TË PESHKIMIT PËR SPECIET KRYESORE FUNDORE NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18) [REKOMANDIMI GFCM/44/2021/1]

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 3, të Marrëveshjes "Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun", të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e Rekomandimit GFCM / 44 / 2021/1 të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, "Për vendosjen e një regjimi sforco të peshkimit për speciet kryesore fundore në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)", që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Të gjitha anijet e peshkimit fundor, që peshkojnë peshq fundorë, nuk duhet të kalojnë 22 109 ditë peshkimi në vitin 2022, të ndara sipas llojit të veglës së peshkimit dhe segmentit të flotës, në përputhje me shtojcën 1 të rekomandimit, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ditët e peshkimit ndahen sipas segmenteve të flotës për anijet e peshkimit fundor që përdorin rrjetë fundore me timon (OTB), si më poshtë:

a) segmenti ≥ 12 m dhe < 24 m: 16 297 ditë;

b) segmenti ≥ 24 m: 5 812 ditë.

4. Ngarkohet Sektori i Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Inspektorati i Peshkimit të monitorojnë konsumin e kuotës së sforcos ose kufirin e sforcos, në përputhje me pikën 3 të këtij urdhri, të shprehur në ditët e peshkimit për çdo segment flote.

5. Sektori i Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe të Programeve të Peshkimit bën verifikimin dhe rishpërndarjen e ditëve të peshkimit midis veglës së peshkimit të përdorur ose segmentit të flotës, në zbatim të një faktori kombëtar konvertimi, i cili mbështetet në këshillat më të mira shkencore të disponueshme.

6. Nga data kur kuota e sforcos është përmbushur ose është arritur kufiri i sforcos, Inspektorati i Peshkimit ia komunikon Sektorit të Monitorimit, Përpunimit dhe Analizës së të Dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit.

7. Sektori njofton ndalimin e peshkimit, në rastin kur kuota ose kufiri i sforcos është arritur nga të gjitha anijet e peshkimit, sipas veglës së përdorur ose segmentit të flotës.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

REKOMANDIMI GFCM/44/2021/1, "PËR VENDOSJEN E NJË REGJIMI SFORCO TË PESHKIMIT PËR SPECIET KRYESORE FUNDORE NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)

Duke marrë parasysh këshillat më të fundit shkencore, miratuar nga Komiteti i Këshillimit Shkencor (SAC) në sesionin e tij të 22-të, duke treguar mbi shfrytëzim të vazhdueshëm të specieve kryesore fundore në detin Adriatik dhe nivele biomase të ulët, veçanërisht për Merlucin dhe Skampin;

Duke sjellë në vëmendje se 2021 është viti i fundit i periudhës kalimtare të regjimit të sforcos së peshkimit përcaktuar në nenin 11 të Rec. GFCM/43/2019/5;

Duke sjellë në vëmendje se në janar 2022 do të vendoset shpërndarja e parë e sforcos së peshkimit, duke u mbështetur në këshillat e SAC-së. Kjo është shpërndarja e parë e sforcos, në një regjim pesëvjeçar të sforcos së peshkimit i vendosur për 2022–2026, i cili do të lejojë arritjen e objektivave përcaktuar në nenin 9;

Duke sjellë në vëmendje se kjo shpërndarje do të shprehet në ditë peshkimi për CPC dhe grup sforco për segmentet e flotës dhe veglës së përdorur;

Duke marrë parasysh se GFCM-ja duhet të sigurojë që, për secilën CPC, rritja ose zvogëlimi i shpërndarjes së sforcos të jetë në përputhje me formulën përcaktuar në shtojcën 4 të Rec. GFCM/43/2019/5 dhe me sforco totale në vitin referues në një zonë, sipas grupet e sforcos të listuar në shtojcën 3, siç raportohet duke filluar nga 2021;

Miraton, në përputhje me dispozitat e neneve 5(b), 8(b) dhe 13 të Marrëveshjes së GFCM-së, rekomandimin si më poshtë:

1. Reduktimi vjetor i vdekshmërisë nga peshkimi (F) i nevojshëm, për të siguruar MSY-në (Fmsy) përcaktuar për 2026-ën për të gjitha speciet kryesore, duhet të jetë një reduktim progresiv linear deri në MSY. Referuar sa më sipër, reduktimi total i sforcos së peshkimit në 2022 duhet të jetë 7% për OTB-në dhe 3% për TBB-në.

2. Shpërndarja e sforcos së peshkimit për 2022, përcaktuar në nenin 1 të këtij rekomandimi, në këshillat më të fundit shkencore dhe në nenin 12 të Rec. GFCM/43/2019/5, janë listuar sipas CPC-së

dhe grupe sforcoje në shtojcën 1 të këtij rekomandimi. Shpërndarja e sforcos për 2022-shin duhet të mbulojë të gjithë periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor dhe ditët e peshkimit, e ushtruar në muajt paraardhës hyrjes ligjore në fuqi të këtij vendimi, do të llogaritet, sipas grupit të sforcos, kundrejt konsumit të sforcos së 2022.

3. CPC-të mund të ndryshojnë shpërndarjen e sforcos, duke transferuar ditët e peshkimit midis grupeve të sforcos të së njëjtës zonë gjeografike dhe/ose vegle të përdorur, me kusht që të zbatojë një faktor kombëtar konvertimi, i cili mbështetet në këshillat më të mira shkencore të disponueshme. Më 2022-shin SAC do të sigurojë faktorët e konvertimit. Ndryshimi i ditëve të peshkimit dhe faktorët e konvertimit duhet të bëhen të disponuheshme menjëherë, dhe jo më vonë se 10 ditë pune, te Sekretariati i GFCM-së dhe CPC-ve të tjera.

4. Shpërndarja e ditëve të peshkimit, sipas gjatësisë së anijes, përcaktuar në nenin 2 dhe shtojcës 1 të këtij rekomandimi, nuk do të zbatohen për segmentimet e ardhshme të flotës.

SHTOJCA 1

Tabela 1. Shpërndarja tranzitore e sforcos së peshkimit për CPC-të e përfshira, shprehur në ditë peshkimi dhe grupe sforcoje, për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2022

					Ditë peshkimi 2022		
Vegla e peshkimit	**Zona gjeografike**	**Speciet e rrezikuara**	**Gjatësia e anijes**	**Kodi i grup-sforcos**	**BE**	**Shqipëria**	**Mali i Zi[1]**
Rrjetë fundore me timon (OTB)	Nënzonat gjeografike 17 dhe 18	Barbuni; Merluci; Karkaleci rose i thellësisë dhe Skampi	< 12 m	OTB12 <	**13909**	**0**	
			≥ 12 m dhe < 24 m	OTB12-24	**103341**	**16297**	
			≥ 24 m	OTB >24	**9107**	**5812**	
Rrjetë me shfletim (TBB)	Nënzonat gjeografike 17 dhe 18	Gjuhëz	< 12 m	TBB12 <	**200**	**0**	
			≥ 12 m dhe < 24 m	TBB12-24	**3747**	**0**	
			≥ 24 m	TBB >24	**3726**	**0**	

[1] Mali i Zi nuk duhet të tejkalojë limitin e sforcos prej 3000 ditëve peshkimi në vit, në përputhje me nenin 13 të Rec. GFCM/43/2019/5.

KËRKESË
Nr. 614/10, datë 21.12.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti "Zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë, faza 2", Bashkia Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5,829,376 (pesë milionë e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I SIPËRFAQEVE TË VARREZAVE PUBLIKE TUFINË FAZA 2"

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim				Shënime (kufizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)
												"Arë/vresht/pemëtore"			Vlera totale (lekë)	
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale arë/vresht/ pemëtore (m²)	Arë/vresht/ pemëtore (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q
1	Qazim	Veli	Daja	Tiranë	3426	26/6	Arë	620	620	1	4	501	448	224,448.00	224,448.00	
2	Qafile Lulzim	Reshit	Daja; Daja	Tiranë	3426	26/58	Arë	1676	1676	7	144	1650	448	739,200.00	739,200.00	
3	Ali	Haxhi	Daja	Tiranë	3426	26/31	Arë	500	500	6	58	500	448	224,000.00	224,000.00	
4	Bashkim	Nezir	Hasmeta	Tiranë	3426	26/65	Arë	3600	3600	7	196	3001	448	1,344,448.00	1,344,448.00	
5	Eqerem	Selman	Lala	Tiranë	3426	26/61	Arë	1330	1330	7	192	1330	448	595,840.00	595,840.00	
6	Ali	Haxhi	Daja	Tiranë	3426	26/32	Arë	600	600	60	59	600	448	268,800.00	268,800.00	
7	Ali	Haxhi	Daja	Tiranë	3426	26/33	Arë	1500	1500	6	60	1500	448	672,000.00	672,000.00	
8	Fatime; Besnik; Hasan; Edmond; Fatime; Shqipe;	Rustem; Xhelal; Xhelal; Xhelal; Rustem; Xhelal	Shima	Tiranë	3426	26/53	Arë	4400	4400	7	139	3771	448	1,689,408.00	1,689,408.00	

9	Qamil	Selman	Lala	Tiranë	3426	26/63	Arë	2060	2060	7	194	40	448	17,920.00	17,920.00	
10	Kadri		Cakmaku	Tiranë	3426	26/60	Arë	873	873	7	146	119	448	53,312.00	53,312.00	
11	Shtet			Tiranë	3426	26/51	Arë	1150	1150	7	137	371	0	0.00	0.00	
12	Shtet			Tiranë	3426	26/37	Arë	510	510	6	223	510	0	0.00	0.00	
13	Shtet			Tiranë	3426	26/5	Arë	900	900	1	15	900	0	0.00	0.00	
14	Shtet			Tiranë	3426	26/4	Arë	3600	3600	1	57	3600	0	0.00	0.00	
15	Shtet			Tiranë	3426	26/56	Arë			7	142	31	0	0.00	0.00	
16	Pa informacion			Tiranë	3426	493	-					513	0	0.00	0.00	
17	Bashkia		Tiranë	Tiranë	3426	26/42	Arë	207	207	7	128	207	0	0.00	0.00	
18	Bashkia		Tiranë	Tiranë	3426	26/43	Arë			7	129	261	0	0.00	0.00	
19	Pa informacion			Tiranë	3426	Pa informacion						249	0	0.00	0.00	
												19654		SHUMA	**5,829,376.00**	
1. Për tokën bujqësore, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.																
2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në të dhënat e marra nga konfirmimi i Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Rurale 1, me nr. prot. 8286, datë 26.11.2021.																

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 201
Datë: 2021/12/24 14:43:09
ea4ae3c5-9773-4a7f-b859-afee0df22d52

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë